



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE
PROJEKT VENDIM
Nr.7 datë 22.08.2025

Rishqyr: Vendimi nr.36 dt.26.06.2025 "Mbi dhënien e ndihmës financiare familjes së z.Pjeter Mirash Gjoni që i është dëmtuar banesa si pasojë e zjarrit të rënë me dt.16.05.2025 banorë i Bashkisë Vau-Dejës"

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhezimin Nr.3 dt.28.12.2016 "Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave për vitin 2016, si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër "Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orëdivë dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve" si dhe pas shqyrtimit të projekt vendimit nr.5 dt.13.06.2025, paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile, ku propozohet dhënia e ndihmës financiare për shtetasin **Pjeter Mirash Gjoni** banorë i fshatit **Fshat i Ri** të Njesisë Administrative Bushat të Bashkisë Vau Dejës, Këshilli Bashkiak

VENDOSI:

1. Kompensimin financiar të banesës së dëmtuar për familjen e **z.Pjeter Mirash Gjoni** pasi bazuar në shkresën e Prefekturës nr.444/1 dt.09.07.2025 e protokolluar nga ana jonë 3634/1 dt.11.07.2025 ka paraqitur statusin juridik të pronës perditsuar 3(tre) muajt e fundit nga ASHK sipas aplikimit date 12.08.2025 (dokumenti bashkengjitur).
2. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.
3. **Burimi i financimit** do të jetë pjesërisht fondi i kushtëzuar i vitit 2025 sipas shkresës nr.492/1 dt.25.02.2025 e protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.991 prot dt.27.02.2025 "Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për programin e Mbrojtjes Civile" në masën 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) leke ndërsa pjesa e mbetur prej 1.000.851.⁵ (një milion e tetëqind e pesëdhjetë e një pike pesë) është fondi i Bashkisë i planifikuar për programin e Mbrojtjes Civile i miratuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.84 dt.23.12.2024 "Mbi miratimin e buxhetit 2025" konfirmuar nga Prefektura Shkodër me shkresën 860/1 dt.06.01.2025.

Konfirmoi bazen ligjore

Silvana Brnjaj
Konceptoi

Valjeta NIKAJ
Valjeta NIKAJ

KRYETARI I BASHKISË

Kristian SHKRELI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETARI

Aleksandra GJONI